



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

KARTË TEKNOLOGJIKE

E permiresuar

TEKNIKAT E KRASITJES NË RRUSHIN E TAVOLINËS

Krasitja dimërore në hardhi

“Të më punojë kush të dojë, por të më krasitë imzot” është një thënjë e vjetër për vreshtarinë dhe mjaft e rëndësishme për krasitjen e saj.

Krasitja si koncept: *“Tërësi operacionesh për të pakësuar një pjesë të kurorës që tashmë ka frutifikuar dhe detyrojmë pjesën tjetër për zhvillim vegetativ dhe prodhim”.*

Qëllimet kryesore të krasitjes:

Realizohet një formë e stabilizuar e hardhisë lidhur me:

-Pjellorinë e tokës,

-Kushtet klimatike si dhe -Tipi i vreshtit.

Vendoset një raport i drejtë midis masës vegetative dhe prodhimit.

Disiplinohet zhvillimi në pjesë të ndryshme të bimës.

Realizohet ekuilibri i nevojshëm bimë-tokë për marrjen e prodhimeve konstante vjetore.

Zgjatet jeta e hardhisë.

Eliminohen pjesët e sëmura, të thata e gjithçka e tepërt ose e dëmshme.

Favorizon qarkullimin e ajrit, depërtimin e dritës dhe ngrohtësisë.

Lehtëson luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe shërbimet agroteknike.

Garantohet cilësia e prodhimit.

Si përfundim: Realizohet ekuilibri i domosdoshëm biologjik midis pjesës ajrore dhe asaj nëntokësore të bimës, i cili kompletohet dhe mbyllet përfundimisht me operacionet e gjelbra (krasitja verore) si vazhdim i krasitjes dimërore.

Pse krasitja është një e keqe?

Sepse prish raportet e vendosura gjatë vitit vegetativ midis bimës dhe tokës.

Pse krasitja është e domosdoshme?

Për të gjitha arsyet e renditura më sipër.

Llojet e krasitjes

Nga pikpamja e moshës ndahen:

Krasitje formuese

- Krasitje prodhuese
- Krasitje ripërtëritëse

Krasitje të veçanta (nga ngrica, breshëri, kanceri etj.,).

Qëllimi i krasitjes formuese:

Krijimi i një trupi të drejtë mbi të cilin shpërndahen elementët e prodhimit në vitet që pasojnë.

Teknika e kryerjes:

Në vitin e parë

Pas mbjelljes (janar të vitit pasardhës të mbjelljes) paraqiten disa raste nga pikpamja e fuqisë së bimës:

- Kur 1 ose 2 lastarë të çelur, gjatë vegetacionit, kanë patur zhvillim të dobët duke arritur gjatësinë e pjesës së pjekur jo me shumë se 30-40 cm dhe trashësi 3-4 mm. Në këtë rast krasitja bëhet duke lënë vetëm 1 lastar me 2-3 sytha të pjekur dhe të pa dëmtuar.
- Kur lastari ka gjatësinë të konsiderueshme deri në 1m, por mjaft i hollë (4-5 mm). Edhe në këtë rast krasitja bëhet duke lënë vetëm 2 sytha (lënia e një lastari të gjatë, por të dobët, do të krijonte mundësinë e një zhvillimi të madh gjatë vegetacionit të 1-2 lastarëve të bazës, duke mos shfrytëzuar dot vitin e dytë, gjatësinë e arritur vitin e parë).
- Kur lastari në fund të vegetacionit të vitit të parë ka arritur gjatësinë e pjesës së pjekur mbi 1m dhe trashësinë mesatare rreth 9-10 mm: Në këtë rast krasitja bëhet duke lënë qysh vitin e parë lastarin e zhvilluar (që do të jetë trungu i ardhshëm i bimës) në gjatësinë e shtrirjes së telit bazë plus 3-5 sytha (që do të jenë fillesa e kordonit bazë). Lënia e më shumë sythave, në këtë rast, do të sillte për shkak të fenomenit të polaritetit në hardhi, mosçelje të sythave të bazës dhe si pasojë problem të formimit të një kordoni teknikisht të rregullt. Sythat nën lartësinë e telit bazë qorrohen të gjithë gjatë procesit të krasitjes.

- E rëndësishme është që për formimin e një trunгу të drejtë dhe pa deformime, qysh vitin e parë të vendosen hunj mbështetës, pas të cilit do të lidhet, gjatë vegetacionit, lastari më i zhvilluar.


Në vitin e dytë

Në rastin kur nga viti i parë kemi lënë një lastar të gjatë, mbi lartësinë e telit, (rasti 3) gjatë vegetacionit, hiqen të gjithë lastarët e dalë poshtë lartësisë së telit bazë, ndërsa lastari i parë i çelur në sythin e parë të kordonit shtrihet për të formuar krahun tjetër të kordonit, në rastin e kordonit bilateral. Në krasitjen dimërore punohet sipas formës së mbajtjes së përcaktuar në projekt, për krijimin e elementeve prodhuese, por gjithmonë me një ngarkesë racionale, për të realizuar vitin pasardhës një çelje të plotë dhe uniforme të sythave, lastarët e të cilëve do të jenë baza e formimit të elementëve të viteve pasardhës.

Në rastin kur nga viti i kaluar, kemi lënë në krasitje dimërore 1 lastar me 2-3 sytha, nga lastarët e çelur, atë më të fuqishmin e më të udhëheqës, duke e lidhur disa herë pas kunjit për të formuar një trunг të drejtë, ndërkohë që 1-2 lastarët e tjerë më pak të zhvilluar i pincojmë për të shërbyer gjatë vegetacionit si organe ushqyes të bimës. Vitin e tretë këta lastarë largohen plotësisht nëpërmjet krasitjes dimërore.

Në vitin e tretë

Kemi krijuar të dy krahët e kordonit, në rastin e kordonit bilateral, ose kordonin e plotë (deri në distancën, në kufirin me bimën fqinje), në rastin e kordonit të një-anshëm.



Në lastarët që kanë shpërthyer gjatë vegetacionit mbi krahët e kordonit, lihen në çdo 20-25 cm, çepa me 2 sytha, në lastarët e të cilëve vitin e katërt e më pas realizohen format e dëshiruara të krasitjes.

Është për t'u theksuar fakti që në bimë të ndryshme të të njëjtit vreshtë (mbi bazën e zhvillimit individual të çdo bime), kryhen krasitje të ndryshme me karakter formimi në të njëjtin vit, në përshtatje me vetë bimën.

Krasitja prodhuese

Qëllimi:

Krijimi i ekuilibrit të drejtë vegetativo -produktiv. Realizohet nëpërmjet 3 sistemeve të krasitjes prodhuese:

Sistem i krasitjes së *shkurtër*, (të dy elementët, si të zëvendësimit dhe të prodhimit, përfaqësohen nga lastarë me 2-3 sytha), format më të njohura dhe të përdorura: Kordon roaja dhe forma Kupore.




Fig.1 Para krasitjes së shkurtër



Fig. 2 Pas krasitjes së shkurtër



Fig. 3 Krasitje e shkurtër, forma Kordon Roaja me cepa.



Fig. 4 Bima e hardhisë në prodhim

- Sistem i krasitjes së *gjatë*: Në bimë ndodhen vetëm lastarë me jo më pak se 7-8 DHe më shumë sytha, pa praninë e çepave me 2-3 sytha. Format më të njohura e më të përdorura: (Sylvoz dhe Kazarsa e një dhe dy anëshme, etj.,).

- Sistem i krasitjes së *përzjerë*: Kombinim i të dy sistemeve (ndeshen element të çepave me 2-3 sytha, si dhe elemente prodhimi me sharmenda me 7-8-12-16 sytha, në varësi të faktorëve të tjerë. Format më të njohura: Gyjo (mono dhe dopio), Kaznav, Kurriz peshku, etj.,.



Fig.5 Gjatë krasitjes.



Fig. 6 Krasitje e përzjerë, forma Mono Gyo cv. Pulës

Shamogjin në QTTB Vlorë

Nga se varet zgjedhja e një sistemi apo forme krasitje?

1. Terreni

a. Malor, pjerrësi e madhe të terrenit, ose tarraca me sheshe të ngushtë, këshillohet:

Forma *kupore*, ose *mono gyjo*, në varësi të kultivarit.

b. Kodrinor, me pjerrësi mesatare, këshillohet:

Forma *Kordon Roaja*, *mono* ose *dopjo Gyjo*, në varësi të kultivarit.

c. Fushor:

Kultivim me *tenda industriale*, me kultivarë *tavoline* ose për *tharje*, ose forma “*Kaznav*”, “*Kazarsa e modifikuar*”, etj,

2. Pjelloria natyrale dhe plehrimi

Në toka të pasura ose me mundësi plehrimi ushqyes, preferohen *forma të larta kultivimi*, me ngarkesë maksimale, të *kultivarëve të tryezës* dhe me më pak ngarkesë në *kultivarët industrialë* duke patur si kusht kryesor cilësinë dhe destinacionin e prodhimit. Tendencat e sotme: Rritja e cilësisë së prodhimit nëpërmjet uljes së ngarkesës me sytha dhe kompensimi i prodhimit të planifikuar me rritjen e numrit të bimëve për ha.

3. Distanca e mbjelljes dhe numri i bimëve për ha.

-ne distanca mbjellje të mëdha *këshillohet sistem i përzjerë i krasitjes* dhe

- në distanca të vogla: *sistem i shkurtër me elementë të reduktur të sistemit të gjatë.*

4. Kultivari

Rëndësi në zgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm të krasitjes ka *Kultivari*, lidhur kjo me aftësinë prodhuese të sythave në gjatësi të sharmendës.

5. Sipas destinacionit të prodhimit

- Kultivarët që preferojnë formë krasitje të shkurtër (2-4 sytha), janë:

Kultivarë tryeze	Kultivarë për përpunim
Alfons Lavale (Prodhim i mirë, kr.sh. m,gj.)	Sheshi i Zi (sh.mirë, verë e kuqe, kr.shkurt)
Kardinal (Prodh.mirë, kr. m.)	Sheshi i Bardhë (sh.mirë, verë e bardhë, kr. shkurt)
Vlosh (sh.mirë, verë e kuqe, kr.shkurt)	Moskat Hamburg (Prodhim i mirë, kr.sh. m.)
Moskat Aleksandrie (Zibbibo)	Karignjan
Shaslla dore' (Jug.shkurt-Veri.gjatë)	Merlot (pr,mirë, verë e kuqe, (3 sytha)
Moskat D`adda (shkurtër –mesatare).	Prodhonjësit direkt (<i>hibridet</i>).
Sangjenoveze (kr, shk.-mes. verë e kuqe).	
Montepulciano (kr, shk.-mes. verë e kuqe)	
Kabernet Sovignon (kr, shk.-mes. verë e kuqe)	
Negro amaro (kr, shk, verë e kuqe)	
Kallmet (mirë- sh.mirë, verë e kuqe, kr.shkurt)	
Trebiano Romanjolo (kr.sh-mes, verë e bardhë)	
Reisling Italian (vere e bardhë)	
Shardone (verë e kuqe, kr.shkurt)	

*Kr, shk.mes- krasitje e shkurter deri ne mesatare.

- Kultivarët që preferojnë krasitje me sharmend, me gjatësi mesatare (6-8 sytha e deri në të gjatë 10-12 sytha.

Kultivarët

- Regina dei vignjeti (rrush per tryeze)
- Perla ksaba
- Barbera (verë e kuqe)
- Malvasia (verë e bardhë)
- Perleta (rrush per tryeze)
- Panse Prekoçe
- Hibridi V-6
- Alfons Lavale (rrush per tryeze)
- Lambrusco maestri (verë e kuqe)
- Viktoria (rrush per tryeze)
- Diamante (rrush per tryeze)
- Matilda (rrush per tryeze)

- Mikele Palieri (rrush per tryeze)
- Perlon (rrush per tryeze)
- Krasitje të gjatë-shumë të gjatë deri në shumë të gjatë (10-16 sytha)

Kultivar rrush tryeze:

Kultivarët me farë

Italia (rrush per tryeze)
 Afuzali Rexhina Bianka (rrush per tryeze)
 Tajkat (rrush per tryeze)
 Alfons Lavale (rrush per tryeze)
 Regina dei vignjeti (rrush per tryeze)
 Shardone (rrush per tryeze, i kuq, krasitje e gjatë)

Kultivarët pa farë

Sulltanina e bardhë (rrush per tryeze-per tharje)
 Sulltanina rozë (rrush per tryeze-per tharje)
 Taif rozë (rrush per tryeze-per tharje)
 Sublima Sedles (rrush per tryeze-per tharje).

- Varietet e vendit si Kallmeti, Sheshi i zi, Sheshi i bardhë duhet të mbillen në vreshtat e reja, sepse vlera e tyre ekologjike dhe prodhimi që ato japin, janë të larta dhe cilësore. Aplikimi i çdo lloj krasitje jep rezultatet e dëshiruara kur shoqërohet me kompleksin tërësor të masave agroteknike. Krasitja jep vetëm mundësinë e shfrytëzimit maksimal të potencialit prodhues të secilit kultivar.

Koha e krasitjes

Për zonën e ulët bregdetare të vendit: Fundi i Dhjetorit - 10 Shkurt.
 Për zonën e ftohtë (paramalore e malore): 20 Shkurt - 10 Mars.

Lartësia e trupit të hardhisë. Bazuar në lartësinë e trupit, grupohen:


- Me trup të shkurtër, deri 30 cm; me trup mesatar, 40-70 cm; me trup të gjatë, > 80 cm;

Lartësia varet nga: Veçoritë e tokës; N/shartesa; Shkalla e mekanizimit.

I . Format me trup të ulët


I.1. Forma Kupore e krasitjes ose “cung me kokë”, 10-30 cm:

Kultivarët “Sheshe” dhe “Vlosh”, më pak kultivari. “Pino i zi”, “Katroshe” dhe “Serin i zi”.
 Distanca: 1m x 2m = 5000 bimë/ha.




I.2. Kordoni me çepa, kjo mund të jetë me trup mesatar 60-80 cm dhe trup të lartë 120 cm:
Kultivarët “Shesh i Zi”, “Vlosh”, “Syrah”, “Reisling” dhe “Kabënet”.

I.3. Forma Kordon Roaja e krasitjes




II. Format me trup mesatar

II.1. Forma Gyjo (një dhe dy anëshme) e krasitjes:



II.2. Forma “Dalmatin i Splitit”, përhapur në bregdetin Adriatiko-Dalmat (Split) me trup 40-60 cm, çep-sharmendë, me sharmendë të mbështetur në hu ose me majë në tokë.

II.3. Forma “Kordon Kaznav” ose “Kordon me hallka prodhimi”, përhapur në Mesdhe, trupi 60-80 cm, dy hallka prodhimi, çepi dhe sharmenda mbi krah shtrirë në tel.



II.4. Forma “Kordon Bordo”, ose forma Gyo me sharmenda të përkulura, ku përkulja e degëzimeve dhe trupit fillon në mesin e telave të parë të spalierës dhe sharmenda fiksohet në telin e dytë, përkulë të lehtë dhe fiksohet në telin e parë të spalierës.

III. Format me trup të lartë


III.1. “Kordoni Kurriz peshku”

Me spalierë të veçantë, ku në lartësinë e trupit të bimës vendoset një shtyllë druri tërthor që ndahet në dy pjesë simetrike me nga 50 cm në çdo anë. Në mënyrë horizontale lihen 3 tela, i pari në drejtim të rreshtit, dy të tjerët paralel anash 50 cm larg njëri-tjetrit duke krijuar një spalierë horizontale. Në pjesën tjetër të shtyllës, pjesa vertikale, lihen 2-3 tela të tjerë në distancë 50-60 cm larg njëri-tjetrit duke formuar kështu spalierën vertikale. Distancat e mbjelljes 2.5-3 m me 1.2-1.5 m bima nga bima. Krahu lidhet në telin e mesit duke formuar kurrizin e peshkut. Ka 2-6 hallka prodhimi, me ngarkesë 20-40 sytha, hallkat në largësi 25-30 cm, duke u alternuar njëherë majtas dhe një herë djathtas. Jep rendiment të lartë por për efekt të polaritetit shkakton tharje të hallkave të prodhimit. Për këtë arsye Prof. Dr. L. Avramov e modifikoi në formë të ngjashme me Gyjon duke krijuar kurriz peshku të një ose dy anëshme, duke bërë degëzimin e trupit të bimës në 15-30 cm mbi pikën e shartimit. Ku secili degëzim lidhet në telin e mesit.

III.2. “Kordoni Silvoz”

Formuar nga francezi Charl Sylvoz në Savoy të Francës Juglindore. Ngjan me formën Kaznav, por me dy ndryshime:

- a- Bimët lihen me trup 100-120 cm të lartë dhe krahu i sharmendës lidhet në telin e dytë të spalierës.
- b- Sharmenda me 6-8 sytha i përkulet maja dhe lidhet në telin e parë të spalierës.



III.3. Forma “Istri”, ose “Perde”, në Kroaci, Mal të Zi , Austri, Serbi etj., tek ne në Shqipërinë e mesme.

Trupi i bimës lihet 100-120 cm lart, mbi të cilën lihet vetëm një sharmendë. Spaliera përbëhet vetëm nga një tel në krye të bandierës, ku sharmenda lidhet në tel dhe gjatë vegetacionit, lastarët bien poshtë duke formuar perden. Distancat janë: 1.8-2 m me 0.8-1 m bima nga bima. Rekomandohet në sipërfaqe të pjerrëta, pa lagështi, ku sythat e bazës nuk arrijnë të diferencohen mirë.

III.4. Forma “Kordon me kate”, ose tek ne “Palmetë” ose “Gyjo e dyanshme me kate”.

Krijohet një kurorë me 2-3 kate, ku kati i parë krijohet në lartësi 100 cm nga toka dhe katet e tjera 50-60 cm larg nga njeri tjetri, ku secili kat është gyjo e dyanshme. Në SHBA është quajtur “Kordoni i Nifinit” me 3 kate dhe zgjat 6 vjet. Distancat e mbjelljes janë 3 m x 1.5 m. Edhe këtu Prof. L. Avramov e ka modifikuar duke lënë lartësinë e trupit në 15-30 cm mbi tokë.

Këshilla praktike

Plaga të qëndrojnë nga sipër pjesës që mbetet, duke e prerë në anën e kundërt të sythit të sipër, 1.5 -2 cm mbi syth. Kjo mbron sythin nga lotimi dhe ngricat.

Prerje të rrafshta, të lëmuara dhe pa shqyerje. (trup, krahë).

Pjesa e butë e gërsërës në pjesën që mbetet.

Prerje të tërthorta dhe jo vertikale, sepse prerjet me diametër >1.5 cm mbyllen me vështirësi, larg njëra tjetrës.

Në prerjet ripërtëritëse si krahë apo pjesë shumëvjeçare prerja duhet të jetë 3 cm sipër nyjes apo degëzimit, kjo për arsye se sythat e fjetur që ndodhen në bazën e krahut apo sharmendës të kenë mundësi aktivizimi.

Krasitje jo në kohë me shi.

Dizinfektimi i plagëve të rënda pas krasitjes.

Ndihmesa në krasitje me dorën e majtë.

KARAKTERISTIKA TË DISA KULTIVARËVE TË HARDHISË

Për kultivar tryeze

“**Kardinal**” Zhvillim vegetativ mesatar. Bistak mesatar-madh, i shkrifët. Pjellori dhe prodhimtari e lartë. Me pjekje të herëshme. Pa mbulim 15-20 Korrik, me mbulim 15-20 Qershor. Ngarkesa e reduktuar eliminon mosuniformitetin në pjekje. I përshtatshëm dhe për zona të larta. I ndjeshëm ndaj hirit, prekja sado e vogël e këtij paraziti shkakton çarje të kokrrave, cipa shumë e hollë.

“Regina dei vigneti” Zhvillim vegetativ i vogël-mesatar. Bistak mesatar, i shkrifët, kokra mesatare me cipë të hollë. Pjekja e herëshme, konsistenca e tultit e butë, aromatik, rezistencë të ulët në shtypje dhe shkëputje të kokrrës. Pjellori e lartë, prodhimtari mesatare. Prania e farave në kokër 1.8. I përshtatshëm edhe për zona të larta.

“Victoria” Zhvillim vegetativ i vogël deri mesatar. Pjekje e herëshme, me mbulim 15-20 Qershor, pa mbulim 20-30 Korrik. Shumë i përshtatshëm për kultivim në serë. Prodhimtari e lartë, bistak dhe kokërr të madhe, me 1.43 fara, konsistenca e tultit e fortë, pa aromë, rezistencë të lartë ndaj shtypjes dhe shkëputjes së kokrrave. I përshtatshëm për kultivim në të gjitha zonat vitikole



“Black Magic” Zhvillim vegetativ mesatar deri i madh. Rrush i zi, me pjekje të hershme, me mbulim 1-10 Korrik, pa mbulim 10-15 Gusht. Pjellori dhe prodhimtari e lartë, bistak mesatar-madh, mesatarisht i shkrifët, konsistencë e fortë e tultit, pa aromë, cipa e hollë, me 1.27 fara në kokërr, rezistencë e lartë e kokrrës në shtypje, e dobët-mesatare në shkëputje. Për momentin me treguesit më pozitivë në kushtet e vëndit tonë.



“Michele Palieri” I zi, me zhvillim vegetativ mesatar, me pjekje të mesme, plotëson më së miri konvejerin pas kultivarëve të hershëm. Pjellori dhe prodhim mesatar. Bistak i madh, shumë i shkrifët, me krahë, kokra e madhe, tulli krokant, pa aromë, me 1.37 fara, cipa e trashë. Rezistenca e kokrrës në shtypje dhe shkëputje e lartë deri shumë e lartë, rezistencë mjaft e mirë në transport, me pamje të lartë tregëtare.



“Italia” i bardhë, aromatik, me zhvillim vegetativ të madh, me pjekje mesatarisht të vonët, pjellori dhe prodhim mesatar, bistak mesatarisht i shkrifët, i madh, kokra e madhe, cipa e hollë, i

ndjeshëm ndaj hirit dhe vrugut. Kërkon detyrimisht krasitje të përzier me sharmenda prodhimi. Me pamje të lartë tregëtare, rezistencë të lartë në transport.

“Afuzali” Sin. “Regina” I bardhë, me zhvillim vegjetativ të madh. Pjekje të vonëshme, bistak i madh, cilindrik, kokra mesatare-madhe, pa aromë, cipa e hollë, pjellori dhe prodhimtari mesatare. Për prodhime të larta preferon krasitje të përzierë me sharmenda prodhimi mbi 10-12 sytha. Rezistencë mesatare në shtypje dhe shkëputje të kokrrave. I përshtatshëm për kultivim në zonën e parë dhe të dytë të vreshtarisë.

“Sublima” Me zhvillim vegjetativ mesatar-madh, i bardhë pa farë, bistak i madh-mesatar, i shkriqet, pjellori dhe prodhimtari e ulët-mesatare, me pjekje të mesme, cipë e hollë, i preferueshëm nga konsumatori. Rezistencë mesatare e kokrrës në shtypje dhe shkëputje. Ka opinione të ndryshme në drejtim të sjelljes ndaj faktorëve të ndryshëm të ambjentit. Duhet të kryhen prova studimi për rajonizimin optimal të tij.

“Perlon” I zi, pa farë, me rritje të fuqishme, me periudhë pjekje dhjetëditëshi i dytë dhe i tretë i muajt Gusht. Pjellori dhe prodhimtari mesatarisht i lartë. Bistaku i madh, i gjatë, konik, me krahë, mesatarisht i ngjeshur. Kokrra mesatare deri e madhe, me pruinë, tul mishtor, pa aromë. Shkon mirë edhe në kultivim tëndë. Rrushi ruhet mirë si në bimë dhe në frigorifer. Ka nevojë për ndërhyrje mbi bistakët, për reduktimin e ngjeshmërisë.

“Tajka” Kultivar autokton, përfaqësuar nga disa biotipe si “Tajka e zezë”, “Tajka rozë”, “Tajka e Tiranës” etj. Përshtatet mirë në të gjithë vendin sidomos në kultivim tëndë. Me prodhimtari të lartë, me pjekje të vonëshme, me cilësi mjaft të mira të rruajtjes në bimë deri në muajt Nëntor-Dhjetor. Bistak mesatar deri i madh, kokrra me konsistencë shumë të fortë, me fara, rezistente ndaj shtypjes dhe shkëputjes. I vetmi nga kultivarët autoktonë të tryezës që meriton vëmendje.